



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 18 prot.

Kamëz, më 18. 2.2022

V E N D I M

Nr. 15 Datë 18/2 2022

MBI

NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.43, DATË 18.11.2019, TË KËSHILLIT BASHKIAK ‘‘ PËR ORGANIZIMINE VEND PARKIMEVE TË TRANSPORTIT TAKSI 4+1 NË TË GJITHË TERRITORIN E BASHKISË KAMËZ ‘‘

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 18.2.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.09 Datë 17.1.2022 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ‘‘Për Vetëqeverisjen Vendore’’, Ligji Nr. 8308, datë 18.03.1998 ‘‘ Për Transportet Rrugore’’ i ndryshuar, Kryetari i Bashkisë pasi shqyrtoi Relacionin e paraqitur nga Sektori i Liçensave, i propozon Këshillit Bashkiak të miratojë Projekt Vendimin ‘‘ Për Një Shtesë dhe Një Ndryshim në Vendimin Nr.43,datë 18.11.2019, të Këshillit Bashkiak’’Për organizimin dhe përcaktimin e vend parkimeve të Transportit Taksi 4+1 në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz’’, **Këshilli Bashkiak Kamëz’’;**

V E N D O S I:

1. Në Vendimin Nr.43,datë 18.11.2019, të Këshillit Bashkiak ‘‘Për organizimin dhe përcaktimin e vend parkimeve të Transportit Taksi 4+1 në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz’’, të bëhet shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:
 - ✓ Në pikën 2, të bëhet ndryshimi nga 9 vende parkimi te ‘‘Rruga Berisha’’ Kamëz, në 4 vende parkimi.
 - ✓ Në pikën 3, të bëhet ndryshimi nga 3 vende parkimi te ‘‘Rruga Beslidhja’’ Bathore, të zëvendësohen me 7 vende parkimi te ‘‘Rruga Demokracia’’ Bathore.
2. Bashkëlidhur, Relacioni shpjegues i Vendimit dhe hartat përkatëse sipas ndryshimeve të propozuara për secilën Rrugë me vendndodhjen e saktë dhe përcaktimi i numrit të vend parkimeve Taksi 4+1.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli
Hysen Koldashi